



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E
SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE
MEDIUMET ELEKTRONIKE***

22 Janar 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



lajm

MAQEDONI

FSSHM: Kartelat shëndetësore prej sot janë në dispozicion për qytetarët



Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë Ju informon se prej SOT kartelat elektronike shëndetësore (KESH), për të siguruarit që kanë parashtruar kërkesë për kartelë por akoma nuk i kanë marrur, janë shpërndarë nëpër sportelet e Njësive rajonale të Fondit.

Nga dita e Hënë , 25 Janar 2016, qytetarët do të mund shkojnë dhe t'i marrin kartelat elektronike shëndetësore në sportelet e Njësive rajonale, aty ku edhe e kanë bërë kërkesën. Njëkohësisht, të punësuarit e Fondit do t'i shfrytëzojnë të gjitha mjetet e komunikimit për t'i informuar qytetarët që të shkojnë e t'i marrin kartelat e gatshme.

Flitet për gjithsej 106.541 kartela elektronike shëndetësore të gatshme.

Të gjitha informatat e nevojshme në lidhje me KESH, të siguruarit do të mund të informohen çdo ditë pune prej orës **8:30-16:30** duke u lajmëruar në linjën telefonike pa pagesë **0800 33 222**; përmes postës



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



elektronike info@fzo.org.mk ; helpdesk@fzo.org.mk si dhe në web faqen zyrtare të Fondit, tek pjesa Sigurimi im <https://moeosiguruvanje.fzo.org.mk/>

Aktivizimi i kartelës realizohet menjëherë pas marrjes së kartelës nga ana e të siguruarit, në Fond ose tek mjeku amë. Gjatë shfrytëzimit të parë të KESH tek mjeku amë, i siguruari e jep numrin e identifikimit personal respektivisht, PIN numrin për shfrytëzim të mëtutjeshëm dhe sigurim të KESH.

Fondi për sigurim shëndetësor ka bërë ndryshime në Rregulloren sa i përket formës dhe përmbajtjes së kartelave elektronike shëndetësore, mënyrës së dhënies, shfrytëzimit dhe dëshmisë për kontributet e paguara të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor. Ndryshimi tjetër që ka aplikuar Fondi është se, nga data 1 Shkurt 2016 për foshnjat e posalindura e deri në moshën 3 vjeçare, nuk do të jetë e nevojshme të posedohet kartelë elektronike shëndetësore e veçantë nga shkaku se, fëmija të drejtën e sigurimit shëndetësor e realizon përmes njërit prind.

Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë vazhdon të jetë i përkushtuar ndaj projekteve të planifikuara.



Nga dita e hënë fillon shpërndarja e kartelave elektronike shëndetësore



Një muaj pas afatit të paraparë, Fondi Shëndetësor ka shpërndarë nëpër njësitë rajonale mbi 100 mijë kartela elektronike shëndetësore, ndërsa qytetarët të njëjtat do të mund t'i tërheqin nga dita e hënë. Drejtori i Fondit Orhan Ramadani tha se për foshnjat e posalindura deri në moshën tre vjeçare nuk ka nevojë për kartelë të posaçme elektronike.

“Prej ditës së hënë qytetarët do të mund t'i marrin kartelat e tyre nëpër qendrat rajonale aty ku i kanë bërë kërkesat. Nga 106.541 kërkesat të cilat i kanë bërë qytetarët, prej tyre 34.538 janë kartela dy gjuhësore, të gjitha kartelat janë të gatshme dhe sot i kemi distribuuar në të gjitha njësitë rajonale të fondit. Me ndryshimet



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



e rregullores prej 1 shkurtit të gjithë fëmijët deri në moshë 3 vjecare do të mund të shfrytëzojnë kartelën e prindit”, tha Orhan Ramadani, Fondi shëndetësor.

Ramadani tha gjithashtu se nëpër njësi rajonale ka edhe mbi 60 mijë kartela tjera të cilat prej kohësh nuk janë tërhequr nga qytetarët. Për kartelat elektronike shëndetësore qytetarët kanë paguar prej 100 deri 250 denarë.



Nga e hëna tërheqje e kartelave elektronike shëndetësore



Kartelat elektronike shëndetësore (KESH) për personat, të cilët kanë parashtruar kërkesë, e të cilat akoma nuk i kanë marrë...

Kartelat elektronike shëndetësore (KESH) për personat, të cilët kanë parashtruar kërkesë, e të cilat akoma nuk i kanë marrë, janë shtypur dhe shpërndarë deri te shërbimet rajonale, kumtoi sot Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë (FSSHM).

FSSHM në kumtesë thekson se nga 25 janari, qytetarët, të cilët kanë parashtruar kërkesë, e nuk kanë marrë kartelë elektronike shëndetësore, do të mund ta tërheqin në shërbimet rajonale të Fondit në vendin ku e kanë dërguar kërkesën. Bëhet fjalë për 106.541 kartela elektronike shëndetësore.

Tërheqja e KESH kryhet në sportelet e shërbimit rajonal të FSSHM. Të gjitha informacionet e nevojshme për KESH mund të merren në shërbimet rajonale ose numrin e telefonit falas 080033222 nga ora 8:30 deri në 16:30 çdo ditë pune. Në mënyrë shtesë mund të informohen edhe në e-mail adresën info@fzo.org.mk, helpdesk@fzo.org.mk dhe në ueb faqen e Fondit, në pjesën sigurimi im <https://moeosiguruvanje.fzo.org.mk/>.

FSSHM, gjithashtu informoi se aktivizimi i kartelave të reja kryhet menjëherë pas dorëzimit të KESH personit të siguruar në Fondin ose tek mjeku amë. Gjatë përdorimit të parë të KESH tek mjeku amë personi i siguruar vendos pin për shfrytëzim të mëtutjeshëm dhe mbrojtje të kartelës.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Në mënyrë shtesë, Fondi ka bërë ndryshime edhe në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e kartels për sigurim shëndetësor dhe për mënyrën e dhënies së saj, zhvillimin dhe dëshminë për kontribut të paguar për sigurimin e domosdoshëm shëndetësor dhe nga 1 shkurti i vitit 2016 të gjithë fëmijët deri në moshën trevjeçare nuk ka nevojë për kartelë të veçantë elektronike, sepse fëmija të drejtat e sigurimit shëndetësor do t'i realizojë përmes njërit prind./Mia

TETOVA

shpejt dhe ndryshe

Edhe së paku 1.000 mjek do të edukohen jashtë vendit



Të paktën 1.000 punonjës shëndetësorë sivjet do të dërgohen për edukim jashtë vendit. Edukimi i kuadrit mjekësor jashtë vendit është një masë fundamentale në drejtim të zhvillimit të sistemit shëndetësor, me çka mundësojmë shërbime shëndetësore më me qasje për qytetarët, cilësi më të mirë të shërbimeve shëndetësore si dhe përforcimin e mbrojtjes shëndetësore të të gjitha niveleve.

Këtë sot në konferencë shtypi e theksoi ministri i Shëndetësisë, Nikolla Todorov, i cili tha se me Ligjin për studime mjekësore dhe edukim të vazhdueshëm mjekësor të mjekëve dhe personelit tjetër shëndetësor,

edukimi i kuadrit mjekësor jashtë vendit është paraparë si obligim ligjor i përhershëm i institucioneve shëndetësore publike në nivelin sekondar dhe terciar të mbrojtjes shëndetësore.

“Në bazë të këtij obligimi dhe si operacionalizim i obligimit, Ministria e Shëndetësisë edhe për sivjet është duke përgatitur Program për edukimin e mjekëve dhe personelit mjekësor, si Program të Qeverisë. Në vitin 2015 Ministria e realizoi këtë obligim dhe jashtë vendit për edukim janë dërguar 1.000 punonjës shëndetësorë prej të cilëve 800 mjekë dhe 200 infermiere dhe personel tjetër mjekësor”, theksoi Todorov.

Duke filluar nga viti 2012, deri më tani, potencoi ministri, janë realizuar gjithsej 2.084 edukime të mjekëve, infermiereve dhe personelit tjetër mjekësor jashtë vendit. Sqaroi se një prej qëllimeve primare të këtyre edukimeve është rritja e cilësisë së shërbimit shëndetësor, vendosja e metodave të reja, zvogëlimi i komplikimeve, organizimi më i mirë i punës si dhe bartja e njohurive dhe përvojës nga sistemet dhe spitalet më bashkëkohore në Republikën e Maqedonisë.

Sipas tij, me këtë mundësojnë shfrytëzim optimal të pajisjeve të reja, më bashkëkohore mjekësore të cilat sigurohen në vazhdimësi për institucionet publike shëndetësore në vend.

Një prej qëllimeve më kryesore të këtyre edukimeve është vendosja e metodave të reja dhe pikërisht në këtë drejtim Todorov theksoi se mbi 70 për qind e mjekëve të dërguar në edukime jashtë vendit (nga gjithsej 1.269 mjekë të dërguar deri më tani në edukim), zbatojnë metoda të reja në institucionet e tyre amë, gjegjësisht metoda të cilat janë të reja për mjekun i cili është dërguar në edukim ose janë të reja për institucionin në të cilin është punësuar mjeku.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Theksoi se ka situatë në të cilën ka metoda të cilat punohen në institucionin shëndetësor, por mjeku konkret nuk e ka zbatuar dhe është dërguar për edukim jashtë vendit me qëllim që edhe ai ta zbatojë këtë metodë.

Theksoi disa shembuj për metoda të reja të vendosura në institucionet shëndetësore publike: Në institutin e sëmundjeve të mushkërive të bardha te fëmijët Kozle – janë vendosur dy metoda të reja të cilat për herë të parë zbatohen në spital, ndërsa ato janë pulmoalergologjia e fëmijëve dhe polisomnografia, për të cilat mjekët janë edukuar në spitalin me renome për fëmijë Bambino Xhezu në Romë.

“Në Klinikën universitare për kardiokirurgji shtetërore – janë vendosur më shumë metoda dhe procedura të reja, mes të cilave: bajpas aortokoronar pa përdorimin e makinës për qarkullim ekstrakorporal (në zemër e cila punon, beating heart), revaskularizim total i arterieve të enëve të gjakut koronare, operacionet kardiokirurgjike invazive minimale, operacionet invazive minimale urgjente te pacientët me endokarditis, operacione për rikonstrukcion të valvulës mitrale”, tha Todorov.

Për këto metoda potencon mjekët janë edukuar në spitalin Triemli në Cyrih, Zvicër, si dhe në Institutin për sëmundje kardiovaskulare në Dedinje.

Theksoi se në spitalin e përgjithshëm në Strumicë janë vendosur tre metoda të reja për spitalin (artroskopi, kolonoskopi dhe protezë subtotale në kërdhokull). Për artroskopinë është realizuar edukim i mjekëve në spitalin LIV në Stamboll, Turqi, ndërsa për protezë subtotale edukimi është realizuar në spitalin Tokuda në Sofje, ndërsa për kolonoskopinë edukimi është realizuar në Qendrën klinike në Vojvodinë.

Është vendosur edhe metodë e re, theksoi ministri, për mjekun, i cili është në spital, por ai nuk e ka ushtruar, ndërsa ajo është holecistektomia laparoskopike trajnimi i të cilës është realizuar në Qendrën klinike në Lubjanë.

“Në Klinikën universitare për gjinekologji dhe obstretikë janë vendosur tri metoda të reja mes të cilave edhe eho në zemër te të sapolindurit (eho kardiografi fetale përparuese) për të cilën tre mjekë nga klinika janë edukuar në King’s College me renome në Londër. Mjekët e kësaj klinike janë edukuar në fushën e anesteziës obstretike, ndërsa ajo për shfrytëzimin e lou-flou anesteziës përkatësisht anestezia me rrjedhë të ulët të gazrave, për çka është realizuar edukimi në spitalin Florens Najtingel në Stamboll”, tha Todorov.

Metoda e tretë për të cilën janë edukuar mjekët e kësaj klinike, tregoi, është onkokirurgjia gjinekologjike, pas edukimit të zbatuar në Qendrën klinike universitare Hamburg – Ependorf, ndërsa një mjek është edukuar edhe në An Arbour – Universitet në Miçigen, SHBA.

“Klinika për sëmundje kirurgjike “Shën Naum i Ohrit” – e cila ka vendosur tri metoda të reja – kolonoskopi/gastroskopi (për të cilën është realizuar edukimi në Klinikën në Nirnberg), fat grafting metodë (për të cilën është realizuar edukimi në “Ronald Regan” qendrën mjekësore në Los Anxhelos). Një mjeke nga Klinika për radioterapi dhe onkologji, pas edukimit të përfunduar në qendrën mjekësore me renome në SHBA, Memorial Hermann – Texas Medical Center, në Klinikë ka vendosur metodë të re për trajtim të tumoreve në traktin digestiv dhe pankreas”, potencoi Todorov.

Theksoi se një mjeke e Klinikës universitare për sëmundje të fëmijëve ka përfunduar edukimin në fushën e neurologjisë së fëmijëve dhe neurorehabilitimit në Itali, në spitalin me renome pediatrike Bambino Xhezu, dhe ka vendosur lloj të ri të testeve për distrofi muskulare, fibrozë cistike dhe sëmundje neuromuskulare në këtë klinikë, ndërsa një mjek i Klinikës universitare për sëmundje infektuese dhe gjendje febrile ka vendosur metodë të re fibroskanit, pas përfundimit të edukimit në Qendrën klinike, Beograd.

“Bëhet fjalë për një metodë të cilën për herë të parë e zbaton mjeku, ndërsa njëherit për herë të parë zbatohet në suaza të kësaj klinike, me çka rritet qasja e shërbimeve shëndetësore. Edhe një shembull është metoda e re e vendosur në Klinikën për nefrologji, e cila përbëhet nga krijimi i hartës të enëve të gjakut për të krijuar qasje të gjakut në fushën e nefrologjisë, me çka është siguruar edhe dopler me ngjyrë për zbatim të vazhdueshëm të metodës. Përndryshe në Klinikë kjo metodë është vendosur pas edukimit të zbatuar të një mjeku në Qendrën klinike në Lubjanë” tha Todorov.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Janë zbatuar edhe edukime në fushën e kardiologjisë intervente, të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme për zgjerimin dhe përforcimin e rrjetit për trajtimin e infarktut akut të zemrës, trajnim e nga fusha e mamografisë dhe kor biopsi të gjinjve, kirurgji plastike të gjinjve etj.

Sqaroi se në Spitalin Universitar në Helsiniki janë dakorduar edukime nga fusha e neurokirurgjisë spinale, me kohëzgjatje prej një deri tre muaj, të cilat do të fillojnë gjatë marsit, ndërsa në vijim është komunikimi edhe me disa spitale dhe klinika në Berlin, Lajpcig etj.

Ministria e Shëndetësisë, theksoi, formoi edhe Komision për kontrollin e njohurive të marra nga edukimet, e cila përbëhet prej profesorëve të shquar akademik, ndërsa në nivel mujor mbahen disa takime të komisionit ku bisedohet edhe më hollësisht analizohen njohuritë dhe aftësitë e fituara nga edukimet jashtë vendit.